

Kontaktet në kantonin e Neuchâtel-it

Policia	117
Ambulanca	144
Dora e ndihmës	143
Pro Juventute (linja për fëmijë dhe të rinj)	147
Akomodimi urgjent	0800 880 480
Shërbimi i ndihmës për viktime(SAVI)	
Shërbimi i ndihmës për viktimat (dëgjim, mbështetje psikologjike, informacione sociale dhe juridike) dhe shtëpi pritjeje (strehim për gra dhe fëmijët e tyre)	
Konsultime	032 889 66 49
Zyra e dhunës në familje	032 886 46 36
Shërbim për autorët e dhunës në familje (SAVC)	
Grup mbështetës që synon të ndihmojë autorët për t'i dhënë fund dhunës në familje, qoftë fizike, verbale, psikologjike apo seksuale	032 886 80 08
CUP (Qendra e urgjencës psikiatrike)	032 755 15 15
Qendra e psikiatrisë së Neuchâtel-it – për fëmijë dhe adoleshentë (CNPea)	
Konsultime mjeko-psikologjike për fëmijët dhe adoleshentët	
Malësi	032 755 23 51
Litoral	032 755 23 11
Këshillim për çiftet dhe familjet që kanë shfaqje dhune nga CNP	
Malësi	032 755 24 51
Litoral	032 755 14 68
Qendra e shëndetit seksual - Planifikimi familjar	
Malësi	032 967 61 87
Litoral	032 717 74 35

Për më shumë informacion dhe adresa, skanoni këtë kod QR



DHUNA NË FAMILJE ËSHTË E PAPRANUESHME DHE E DËNUESHME



KËRKONI NDIHMË !

VIGILENCË, THUJAJ STOP!

Ka dhunë.
Ai /ajo...



Kur ju prekin pa pëlqimin tuaj, kur ju detyrojnë të kryeni marrëdhënie seksuale
Kur ju shtyjnë, ju tërheqin, ju godasin me shuplakë, ju shkundin, ju rrahin ose ju shajnë
Ju kërcënojnë verbalisht dhe/ose fizikisht
Kërcënim për postim fotosh ose videosh tuaja intime
Ju bëjnë shantazh emocional, ju kërcënojnë për vetëvrasje
Kur humbasin kontrollin, zemërohen kur nuk u pëlqen diçka

MBRONI VETEN! KËRKONI
NDIHMË!

Këmbëngul që t'i dërgoni foto ose video intime
Përçmon mendimet dhe projektet tuaja, nuk pranon asnjë këndvështrim tjetër përveç të tijit/sajit
Ju kontrollon, ju jep urdhra, ju vëzhgon
Ju injoron, ju refuzon t'ju dëgjojë, ju përbuz
Është xheloz/e dhe posesiv/e
Tallet me ju, ju poshtëron
Ju izolon nga miqtë dhe familja juaj
Prek pa leje telefonin tuaj, gjërat tuaja
Kontrollon daljet, veshjet, makjashin tuaj

PËRFITONI!
Marrëdhënia juaj është
e shëndetshme.
Ai/ajo...

Kërkon mendimin tuaj për vendimet që ju përkasin
Është i/e lumtur kur ju ndiheni i/e plotësuar
Ka besim tek ju
Pranon miqtë dhe familjen tuaj
Respekton personalitetin tuaj, mendimin tuaj, vendimet tuaja dhe shijet tuaja

LIGJI JU MBRON: THËRRISNI POLICINË!

Policia ka të drejtë të shoqërojë në rajon një person të dhunshëm ndaj një antari të familjes. Ajo mund të nxjerrë jashtë, po ashtu, një person të dhunshëm nga banesa dhe rrethinat e saj të afërta për disa ditë, duke i ndaluar atij hyrjen në objekte dhe vende të caktuara. Një masë më e qëndrueshme mund të kërkohet nga viktimat në Gjykatë.

Disa situata të dhunës në familje ndiqen penalisht në mënyrë zyrtare (pa ankesë apo padi). Depozitimi i një padie ju mundëson të shprehni mendimin tuaj në procedurën penale dhe të keni akses në dosje.

JU MUND TË MERRNI NDIHMË

Edhe nëse nuk dëshironi të thërrisni policinë, disa shërbime janë aty për t'ju dëgjuar, për t'ju këshilluar dhe nëse keni nevojë,

- organizojnë akomodimin tuaj në një shtëpi
- shqyrtojnë ndihmat e mundshme financiare
- ju informojnë për të drejtat tuaja

Adresohuni, sidomos, në Shërbimin e Ndihmës së Viktimave (SAVI). Konsultimet janë falas dhe konfidenciale. Ato mund të zhvillohen në prani të një përkthyes/i/eje.

DËSHIRONI TË LARGOHENI NGA SHTËPIA BASHKËSHORTORE ?

Ju keni të drejtë të largoheni nga shtëpia bashkëshortore. Nëse jeni viktimë e dhunës në familje ose nëse ndiheni të kërcënuar, ligji ju lejon të kërkonte mbrojtje. Shkoni te njerëzit, tek të cilët keni besim. Akomodimi i përkohshëm emergjent mund t'ju strehojë, gjithashtu, vetëm ose së bashku me fëmijët tuaj.

Për aq sa është e mundur, në rast agresioni, kërkoni nga një mjek që të hartojë një raport mjekësor të detajuar, i cili përshkruan të gjitha gjurmët dhe lezionet e lëna nga sulmi, duke përfshirë edhe pasojat psikologjike (shok, ankth, pagjumësi). Kjo do t'ju lejojë të ruani për më vonë prova që mund të jenë të dobishme për ju.

Viktimat me origjinë të huaj nuk e humbasin automatikisht lejen e qëndrimit në rast ndarjeje apo divorci. Ato përfitojnë nga një ekzaminim specifik, i cili merr parasysh situatën e tyre personale dhe rrethanat specifike për secilin rast. Informohuni!

RESPEKTOMETËR

Për një marrëdhënie të shëndetshme

Hapi i parë për t'i dhënë fund dhunës,
është të flitet për të !